



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SELENICË
DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË BUIQËSISË DHE ADMINISTRIMIT TË
PYJE/KULLOTAVE

Nr. 2234 Prot.

Selenicë, më 24.09.2025

Lënda: Njoftim për konsultim me publikun.

NJËSISË ADMINISTRATIVE BRATAJ, FSHATRAVE LEPENICË DHE GJORM

Titulli i Konsultimit: Dhënia e dakordësisë për sipërfaqen karrierë prej 50,3 ha, që ndodhet në ZK 1759 (Gjorm) dhe 2415 (Lepenicë), në ngastrat pyjore/kullosore prona të Bashkisë Selenicë, që kërkohet të shfrytëzohet nga Subjekti **“SPA VENUS” SH.P.K Për shfrytëzimin e gurit gëlqeror**, në zonën minerare 70/12, fshati Lepenicë dhe Gjorm.

Sqarime për konsultimin (baza ligjore)

Referuar ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 26,

-Në ligjin 57/2020 “Për Pyjet”,

-Në Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr.1 datë, 09.06.2021 “Për rregullat, procedurat kërkimit të shfrytëzimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të pronave të Bashkisë Selenicë.

-Shkresës së Agjencisë Rajonale të Mjedisit, me nr.2336/2 prot, datë 16.09.2025 “Njoftim për konsultim me publikun” të Subjektit “SPA VENUS” SH.P.K.

-Zona ku kërkohet të merret dakordësia e komunitetit është në Njësinë Administrative Brataj, fshati Lepenicë dhe Gjorm, për karrierë në fushë të hapur, si zonë minerare e shpallur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ku subjekti i mësipërm kërkon, **që të aplikojë për Lejen e mjedisit të zipit B.**

Përsa më sipër, më datë, 30.09.2025, ora 11⁰⁰, do të zhvillohet dëgjese publike me pjesëmarrjen e komunitetit, te Lokali privat “Bar Kafe”, në hyrje të fshatit Gjorm.

Të merren masa nga ana juaj për pjesëmarrje të banorëve në dëgjese.

Ky njoftim do të publikohet edhe në faqen zyrtare të Bashkisë Selenicë

Nga Bashkia do të jenë Zyrtarë të Bashkisë, të D.ZH.B.A.P/K e të tjerë kush dëshiron,

Nga Komuniteti do të marrin pjesë: Banorë të Njësisë Administrative Brataj, fshatrat Lepenicë e Gjorm dhe kush dëshiron të shprehi interes.

KRYETARI

Nertil Bellaj

2188
18.09.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
AGJENCIA RAJONALE E MJEDISIT FIER/VLORË/GJIROKASTËR
SEKTORI I LEJEVE MJEDISORE DHE VNM

Nr. 2336/Prot.

Fier, më: 16.09.2025

Lënda: Njoftim për konsultimin me publikun të Subjektit "SPA VENUS" SH.P.K.

BASHKISË SELENICË

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.247, datë 30.04.2014 "PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE, TË KËRKESAVE E TË PROCEDURAVE PËR INFORMIMIN DHE PËRFSHIRJEN E PUBLIKUT NË VENDIMARRJEN MJEDISORE", Kreu II.

Ju njoftojmë se Subjekti "SPA VENUS" SH.P.K. më datë 30.09.2025 do të organizojë "Konsultim me Publikun", në kuadër të procedurave për pajisjen me Leje Mjedisore të tipit B/Deklarate Mjedisore VNM-Thelluar për aktivitetin:

"SHFRYTEZIMI I GURIT GELQEROR"

Takimi do të zhvillohet në ambjentet e një Lokali Privat (Bar-Kafe), në Fshatin Gjorm, më datë 30.09.2025 në orën 11:00, me vendndodhje ushtrimi aktiviteti në adresën: Zona Minerare nr.70/12 Objekti "Lepenice", Qarku Vlorë.

Raportin e përmbledhjes jo teknike si dhe informacion rreth subjektit do t'i gjeni në adresën: akm.gov.al; [http://akm.gov.al/publiku në vendimarrje](http://akm.gov.al/publiku_në_vendimarrje) ose armfier@akm.gov.al.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj!

*Shpirti i fshatit Gjorm
Gjormi Broty
Dr. Bujku*

DREJTOR RAJONAL
Alban TOSKA

